# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-447117**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kurti për herë të katërt kryeministër/ Rama i dërgon letër: Mirë se të vish në Tiranë |
| ADRESA | `https://piranjat.al/kosova/kurti-per-here-te-katert-kryeminister-rama-i-dergon-leter-mire-se-te-vish-i104307` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 19:00:15 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 18:43:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `851083463a9ad2557e989aa0822afd16293398e745bf4ac3e357c9867ecdfe50` |
| TEKSTI | `f352994b1ac5b3758f1c277efa905560b2c325e4720bbe24feb624e17a6c925a` |
| PAMJA | `f0e714c4b27a07f71fce2690723185df572a4aac3fb51a554ae5ed859b45e56f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `44fd8297b03541434b9d5e9093af99518dd267e61415724c33315848922e8d53` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `7fc79e204ff2dfa3f9e677f0c9d1bacea0122705418ff355483188747d3235b5` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/44fd8297b03541434b9d5e9093af99518dd267e61415724c33315848922e8d53`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Flash: Saudite anulon dërgesat për klientët evropianë, të ■ rasti i dajes së Zegjine Caushit ngre "Pranisë Besnike", kryeministri ■ vendoset edhe për pagat e ndryshime në përbërjen e ■ shqiptare është e furnizuar Efeti, ushtria shqiptare sot ■ me lehtësira fiskale Demokratike kërkon nga qeveria që të

KOSOVA

# Kurti për herë të katërt kryeministër/ Rama i dërgon letër: Mirë se të vish në Tiranë

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 20:43



Kryeministri Edi Rama ka uruar Albin Kurtin për zgjedhjen për herë të katërt kryeministër i Kosovës, duke u zotuar për bashkëpunim. Në letrën e Ramës, konfirmohet gatishmëria e tij për "bashkëpunim të gjithanshëm" me Qeverinë e Kosovës.

"Mandati Juaj i ri qeverisës më ofron rastin e duhur t'Ju përcjell urimet e mia më të përzemërta për sukses. Gjithashtu, e shfrytëzoj këtë mundësi për të riafirmuar gatishmërinë time dhe të Qeverisë që unë drejtoj, për një bashkëpunim të gjithanshëm, në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fushat, për të përshpejtuar hapat në rrugëtimin tonë sfidues drejt Shtëpisë së Përbashkët Evropiane.

Zbatimi sa më i plotë i marrëveshjeve të miratuara dhe shqyrtimi e angazhimi në projekte të reja, nga sektorët më të rëndësishëm e prioritarë, janë në dobi dhe do të përmirësojnë e pasurojnë më tej jetën e qytetarëve tanë", shkruhet në letrën e kryeministrit Edi Rama.

Ai e ka ftuar Albin Kurtin për vizitë në Shqipëri, sipas njoftimit të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës. Zgjedhja e Albin Kurtit kryeministër dhe Qeverisë së tij, sikurse edhe konstituimi i Kuvendit, janë kontestuar në Gjykatën Kushtetuese nga Partia Demokratike e Kosovës.

"Edhe një herë, me urimet e mia më të mira për përparimin e gjithanshëm të Republikës së Kosovës gjatë këtij mandati Tuaj të ri dhe, sërish, me ftesën time të përzemërt për të vizituar Shqipërinë në një kohë të përshtatshme për Ju, pranoni, Ju lutem, Shkëlqesia Juaj, shprehjen e konsideratës sime më të lartë", përmbyllet letra.



Republika e Shqipërisë
Kryeministri

Tiranë, më 14 shtator 2026

Shkëlqesia Juaj,

Mandati Juaj i ri qeverisës më ofron rastin e duhur t'Ju përcjell urimet e mia më të përzemërta për sukses.

Gjithashtu, e shfrytëzoj këtë mundësi për të riafirmuar gatishmërinë time dhe të Qeverisë që unë drejtoj, për një bashkëpunim të gjithanshëm, në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fushat, për të përshpejtuar hapat në rrugëtimin tonë sfidues drejt Shtëpisë së Përbashkët Europiane. Zbatimi sa më i plotë i marrëveshjeve të miratuara dhe shqyrtimi e angazhimi në projekte të reja, nga sektorët më të rëndësishëm e prioritarë, janë në dobi dhe do të përmirësojnë e pasurojnë më tej jetën e qytetarëve tanë.

Edhe një herë, me urimet e mia më të mira për përparimin e gjithanshëm të Republikës së Kosovës gjatë këtij mandati Tuaj të ri dhe, sërish, me ftesën time të përzemërt për të vizituar Shqipërinë në një kohë të përshtatshme për Ju, pranoni, Ju lutem, Shkëlqesia Juaj, shprehjen e konsideratës sime më të lartë.

Sinqerisht,

Edi Rama

**Sh.T.Z. Albin Kurti**
**Kryeminister i Republikës së Kosovës**
**Prishtinë**

## Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 15 Shtator20:34

['Sonte nuk do të fle', aktivistja nga Vushtria pret lirimin e krerëve të UÇK-së: Uroj që nesër të festojë e gjithë Kosova]()

Teksa kanë mbetur vetëm pak orë nga shpallja e vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë për Hashim Thaçin, Kadri Ves...

KOSOVA 15 Shtator20:25

["UÇK-ja ka bërë luftë të pastër"/ Djali i Jakup Krasniqit tregon mesazhin që ia dha i ati, ja çfarë i tha]()

Kur kanë mbetur më pak se 15 orë deri në shpalljen e vendimit të shkallës së parë të Gjykatës Speciale pë...

KOSOVA 15 Shtator20:16

VIDEO/ Pak orë para vendimit për ish-krerët e UÇK-së, në Prishtinë ndizet "Flakët e Lirisë"

[VIDEO/ Pak orë para vendimit për ish-krerët e UÇK-së, në Prishtinë ndizet "Flaket e Lirisë"](#)

Pak orë para shpalljes së aktgjykimit në Hagë për ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në Prish...

KOSOVA 15 Shtator20:15

[Nesër vendimi për ish-krerët e UÇK-së, qindra shqiptarë me flamuj kuq e zi mblidhen në Hagë](#)

Qindra shqiptarë janë mbledhur para objektit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, në prag të shpall...

KOSOVA 15 Shtator19:56

[Shtohet siguria në Hagë para vendimit për ish-krerët e UÇK-së, policia largon shqiptarët nga Gjykata Speciale](#)

Policia holandeze ka shtuar masat e sigurisë përpara ndërtesës së Gjykatës Speciale në Hagë, vetëm pak orë par...

KOSOVA 15 Shtator19:26

[Kongresmeni amerikan paralajmëron Hagën: Paragjykimet politike të mos ndikojnë në vendimin për Thaçin dhe ish-krerët e UÇK-së](#)

Kongresmeni amerikan Keith Self ka reaguar lidhur me vendimin që pritet të merret nga Gjykata Speciale në Hagë për ish-krerët e U&...

KOSOVA 15 Shtator19:21

[Verdikti i Hagës, udhëzimi i Komunës së Prishtinës për shkollat: Ora e parë t'i kushtohet UÇK-së](#)

Një ditë para shpalljes së vendimit të Gjykatës Speciale për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selim...

KOSOVA 15 Shtator18:01

[Procesi ndaj Thaçit në Hagë, ambasadori kroat: Të shikohet në kuadrin juridik](#)

Ambasadori i Kroacisë në vendin tonë, Zlatko Kramarić i cili ka qenë edhe ambasadori i parë i Kroacisë në Kosovë, nga Ko...

KOSOVA 15 Shtator11:41

[Ndërron jetë Flora Brovina, nesër do të dëshmonte për Masakrën e Dubravës](#)

Flora Brovina, ish-deputete e Partisë Demokratike të Kosovës ka ndërruar jetë. Brovina, e cila ka qenë edhe pediatre dhe aktivi...

KOSOVA 15 Shtator09:18

[Reuters: Vendimi për ish-krerët e UÇK-së, "ngjarje tektonike" për Kosovën dhe rajonin](#)

Agjencia ndërkombëtare e lajmeve Reuters i ka kushtuar një artikull të gjerë procesit gjyqësor ndaj ish-presidentit të Koso...

## ME TE VIZITUARAT

BOTA 15 Shtator

[Sulmohet Arabia Saudite, bombardohet me raketa ...](#)

Huthët e Jemenit, të mbështetur nga Irani, kanë nisur një valë të re sulmesh ndaj Arabisë Saudite, ndërsa paralel...

BOTA 14 Shtator

["E drog*va dhe abuz*va gruan për 20 vite"/ Bash...](#)

Një burrë britanik pranoi sot se kishte droguar dhe përdhunuar gruan e tij në shtëpinë e tyre për rreth dy dekada. Burri, ban...

AKTUALITET 15 Shtator

[Rrëfehet 34-vjeçarja: Daja i Zegjine Caushit më...](#)

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak ditë më parë në Roskovec, ku Bledar Bakaj shkoi në shtëpinë e ish-bashk&e...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

## video



**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**






Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.